



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 295, datë 30.05.2023

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT NË PROCEDURAT E LËVIZJEVE PARALELE
NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
DURRËS, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 22 DHE NR. 23 DATË 18.01.2023 TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR KANDIDATËT QË KANË OSE MUND TË
KENË 1(NJË) VLERËSIM**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IV dhe V të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 22 dhe nr. 23 datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim.

2. Caktimin e relatorit si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------------|-------------------------------|
| 1. Për kandidaten znj. Suela Xhani | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 2. Për kandidaten znj. Yrfet Shkreli | - relator z. Alban Toro; |
| 3. Për kandidatin z. Olti Skrame | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 4. Për kandidatin z. Ardit Kuka | - relator z. Dritan Hallunaj; |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
ZËVENDËSKRYETARI**

ILIR RUSI

Spektori i Organizimit të Mbledhjeve: Krisulla Kasaj
Departamenti i Shërbimeve Juridike: Blerta Ngucaj
Sekretar i Përgjithshëm: Rudin Baqli
Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: Klodian Kurushi